



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1530/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Operatori i Transportit Rrugor XX Travel shpk me seli në Pejë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E.K. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.162/22 të datës 24.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Operatori i Transportit Rrugor XXL Travel shpk me seli në Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.162/22 i datës 24.05.2023, Vërtetohet

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e atakuar K.A.nr.162/22 i datës 24.05.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadin e paditësit Operatori i Transportit Rrugor XXL Travel shpk me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi KM-MIT nr.488/19 i datës 11.07.2019 i të paditurës Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave kontestimore dhe administrative, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar, ashtu që ti jepet e drejta për të ushtruar veprimtarinë e transportit tokësor të udhëtarve me autobus në relacionin Junik-Deçan-Prishtinë dhe anashjelltas, kurse Anulohen vendimet e paditues Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë nr.4156 dt.19.04.2019 dhe nr.4946 dt.10.05.2019 si të kundërligjshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, me vendimin e kundërshtuar të paditues KM-MIT nr.488/19 dt.11.07.2019, është Refuzuar ankesa e operatorit ekonomik transportues XXL Travel nga Peja, ndaj vendimit nr.4156 dt.19.04.2019 dhe vendimit 4146 dt.10.05.2019 per refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Junik-Deçan-Pejë, për nisjen në ora 18.15 me kthim 21.00.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditues Ministria e Infrastruktues dhe Transportit në Prishtinë (MIT), ka ushtruar padi në gjykatë, për konflikt administrativ me datën 02.08.2019, me pretendim se vendimi i të paditues është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditues, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datën 17.05.2023 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të përfaqësueses së palës së paditur (neni 41 I LKA-së), dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e Refuzon në tërësi si të pa bazuar, me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë në mënyrë që gjykata të vërtetoj një gjendje tjetër faktike dhe juridike nga ajo e konstatuar nga i padituri në vendimin për refuzimin e kërkesës për dhënien e linjës dhe vendimin për refuzimin e ankesës. Gjykata vendimin e referon në dispozitat e nenit 18 të Ligjit 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe nenit 8 par.1 nenp.1.8 të Udhëzimit nr.09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarve me autobus.

Qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Dhoma Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 41 dhe 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të Transportit Rrugor, përkatësisht nenit 18 të Ligjit 04/L-179 për Transportin Rrugor dhe nenit 8 par.1 nenp.1.8 të Udhëzimit nr.09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarve me autobus.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vleron se gjatë administrimit të provave nga dhoma e shkallës së parë, përveq padis, aktvendimeve kontestuese të paditues, përgjigjes në padi, nuk janë paraqitur asnjë provë tjetër materiale, që do të argumentonte pretendimet e paditësit se ka paraqit dokumente të vlefshme në shpalljen publike për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin Junik-Deqan-Pejë, përderisa si kusht ligjor për ndarjen e nisjeve të lira, Udhëzimi administrativ 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e Udhëtimit të Transportit ndërrurban të udhëtarve me autobus, ka përcaktuar dokumentet per aplikim: tri kopje të udhëtimit sipas formës dhe përmbajtjes së aprovuar nga Ministria.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk kishte marrë parasysh faktin se pala paditëse vërtet i kishte plotësuar kushtet për dhënien e lejes për transportin rrugor të udhëtarve në shpalljen publike 16/43 dt.21.02.2019, dhe me këtë pala paditëse vleron se është shkëlur neni 182.2 (n) e LPK-së, Kolegji vleroi se ky pretendim nuk qëndron, pasi aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjithashtu Kolegji vleroi se nuk janë të mjaftueshme pretendimet deklarative por bie në barrë të paditësit në këtë rast që të dëshmoj me prova konkrete se cilat dokumentacione i ka paraqit para të paditues me rastin e aplikimit për ndarjen e nisjeve të lira ne relacionin Junik-Deçan-Pejë, për ti vërtetuar pretendimet se i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 8 të Udhëzimit Administrativ 09/203 për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e udhëtimit të Transportit Ndërrurban.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, i shqyrtoi edhe pretendimet ankimore se e paditura nuk ka vepruar në pajtim me nenin 85 të Ligjit për Procedurën Administrative, mirepo këto pretendime nuk janë të bazuara për arsye se aktet administrative kontestuese të paditues kanë dhënë arsye të mjaftueshme kur kanë refuzuar ankesën e paditësit në procedurën administrative, duke zbatuar drejt ligjin. E paditura në arsyetim të vendimeve kontestuese, vendimet i ka mbështetur në dispozitat ligjore me të cilat përcaktohen kushtet për dhënien e linjës së udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarve me autobus, prandaj, Kolegji vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji vleroi se gjykata e shkallës së parë me të drejt referohet në dispozitën e nenit 43 paragrafi 1 i LKA-së, se gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, e që në rastin konkret paditësi nuk ka ofruar asnjë provë materiale gjykatës,për ti vërtetuar pretendimet se ka plotësuar kushtet ligjore për dhënien e linjës.

Duke marrë parasysh se dhoma e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë të paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1530/23 datë 08.02.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha